FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 102

Tiranë – E premte, 19 qershor 2015

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 485, datë 10.6.2015	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Sllovakisë, për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm të lëndëve narkotike, substancave psikotrope e prekursorëve të drogës dhe krimeve të tjera.....	5187
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 487, datë 10.6.2015	Për një shtesë në vendimin nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.....	5191
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 488, datë 10.6.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar.....	5191
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 10.6.2015	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Drejtësisë, të pronës nr. 139, me emërtim "Reparti ushtarak nr. 8890, objekte b130", me vendndodhje në Mëzes, Tiranë, të disa objekteve e të një sipërfaqeje trualli funksional, brenda territorit të pronës nr. 109, me emërtim "Sh.a., Riparim Artilerie", me vendndodhje në Brar, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar.....	5192
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 496, datë 10.6.2015	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për prefektin e qarkut të Tiranës dhe administratën e tij, të godinës qendrore të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.....	5196

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 499, datë 10.6.2015	Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës, dhe shoqërisë "MSP Trade Concept", sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë "Ish-NPV nr. 2, Durrës" në "NPV", sh.a., Durrës	5200
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 500, datë 10.6.2015	Për shfuqizimin e vendimit nr. 887, datë 21.12.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin, në parim, të dokumentit ndryshues të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, për programin dypalësh të ndihmës së bashkëpunimit".....	5203
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 501, datë 10.6.2015	Për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave: nr. 1481, datë 12.11.2008; nr. 1657, datë 24.12.2008; nr. 100, datë 27.1.2009; nr. 286, datë 18.3.2009; nr. 450, datë 6.5.2009; nr. 611, datë 11.6.2009; nr. 677, datë 18.6.2009; nr. 706, datë 23.6.2009; nr. 805, datë 22.7.2009; nr. 1038, datë 14.10.2009; nr. 1134, datë 18.11.2009; nr. 1283, datë 23.12.2009; nr. 125, datë 17.2.2010; nr. 247, datë 13.4.2010; nr. 404, datë 26.5.2010; nr. 549, datë 7.7.2010; nr. 646, datë 28.7.2010, nr. 118, datë 7.2.2011; nr. 359, datë 4.5.2011; nr. 822, datë 23.11.2011; nr. 513, datë 1.8.2012; nr. 61, datë 23.1.2013; nr. 686, datë 16.8.2013; nr. 345, datë 24.4.2013; nr. 713, datë 19.10.2014; nr. 279, datë 1.4.2015, të ndryshuara, për miratimin e kalimit të pronësisë së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale.....	5203
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 10.6.2015	Për miratimin e dëmshpërblimit financiar për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist.....	5220
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 504, datë 10.6.2015	Për miratimin e autorizimit të ndërtimit të centralit elektrik eolik, dhënë shoqërisë "Era Milot", sh.p.k.....	5229
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 10.6.2015	Për organizimin, funksionimin dhe shpërblimin e komisioneve eprore të caktimit të aftësisë për punë.....	5232
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 506, datë 10.6.2015	Për disa ndryshime në vendimin nr. 745, datë 5.9.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Qendrës Shumëfunksionale të Arsimit dhe Formimit Profesional në Kamzë dhe funksionimin e saj gjatë periudhës kalimtare 2013 – 2018".....	5240

VENDIM
Nr. 485, datë 10.6.2015

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SLLOVAKISË, PËR BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT, KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIKUT TË PALIGJSHËM TË LËNDËVE NARKOTIKE, SUBSTANCAVE PSIKOTROPE E PREKURSORËVE TË DROGËS DHE KRIMEVE TË TJERA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe neneve 17 dhe 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Sllovakisë, për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm të lëndëve narkotike, substancave psikotrope e prekursorëve të drogës dhe krimeve të tjera, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SLLOVAKE PËR BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT, KRIMIT TE ORGANIZUAR, TRAFIKUT TË PALIGJSHËM TË LËNDËVE NARKOTIKE, SUBSTANCAVE PSIKOTROPE E PREKURSORËVE TË DROGËS DHE KRIMEVE TË TJERA

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Sllovake (më poshtë të quajtura "Palët Kontraktuese"),

- *me synim* për të kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe ndërmjet tyre;
- *duke qenë të interesuara* në bashkëpunimin e ndërsjellë për luftën kundër krimit të organizuar;
- *duke dëshiruar* të forcojnë përpjekjet e përbashkëta në luftën kundër krimit të organizuar;
- *të bindur* për nevojën për të harmonizuar hapat e tyre të drejtuar kundër krimit të organizuar, terrorizmit, trafikut të paligjshëm të lëndëve narkotike, substancave psikotrope dhe lloje të tjera të krimit;
- *duke pasur parasysh* angazhimet ndërkombëtare dhe legjislacionin kombëtar të Shteteve të Palëve Kontraktuese;
- *duke respektuar* Republikën Sllovake si shtet anëtar të Bashkimit Evropian dhe për këtë arsye duhet të veprojnë në përputhje me aktet ligjore të Bashkimit Evropian, kryesisht ato në fushën e prekursorëve të drogës,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Palët Kontraktuese, në përputhje me legjislacionin kombëtar të shteteve të tyre dhe dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, duhet të bashkëpunojnë dhe të sigurojnë ndihmë në parandalimin, zbulimin dhe luftimin e krimit, në veçanti:

a) terrorizmin;
b) krimin e organizuar;
c) krimet kundër jetës, shëndetit, lirisë dhe dinjitetit njerëzor;
d) prodhimin e paligjshëm, importin, eksportin dhe zotërimin e lëndëve narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve të drogës, si dhe trafikimin e paligjshëm dhe tregtimin e tyre;
e) trafikimin e qenieve njerëzore dhe fëmijëve;
f) prodhimin e paligjshëm, importin, eksportin, trafikimin e armëve, municioneve; lëndëve plasëse, substancave toksike dhe të djegshme, materialeve kimike, biologjike, bërthamore dhe radioaktive, produkteve dhe procedurave teknologjike të rëndësisë strategjike apo për përdorim të mundshëm të dyfishtë, dhe tregtinë e paligjshme në teknologjinë ushtarake;
g) krimet që lidhen me tregtinë e paligjshme të monumenteve kombëtare dhe veprave të artit,

objektet me vlerë historike dhe kulturore, si dhe krimet që kanë si qëllim gurët e çmuar, metalet dhe objektet historike dhe kulturore, dhe të trashëgimisë artistike;

h) falsifikim dhe modifikim të parave, letrat me vlerë, mjetet e pagesave pa para në dorë, dokumenteve zyrtare dhe të shpërndarjes së tyre;

i) krimet kundër pasurisë;

j) lojërave të paligjshme dhe skemave mashtruese të përdorura në lojërat e ligjshme;

k) vjedhjet e mjeteve motorike dhe manipulime të tjera të paligjshme me mjetet motorike;

l) operacioneve financiare të paligjshme, legalizim dhe pastrim të produkteve që rrjedhin nga veprat penale dhe krimet e tjera ekonomike,

m) korrupsioni;

n) migracioni i paligjshëm, kalimi i paligjshëm i kufirit dhe qëndrimi i paligjshëm i personave dhe krimet e lidhura me të.

2. Bashkëpunimi ndërmjet Palëve Kontraktuese do të mbulojë informacionin e shkëmbyer mbi dispozitat ligjore në lidhje me veprat penale të përmendura në këtë Marrëveshje.

3. Palët Kontraktuese, me marrëveshje të përbashkët, mund të zgjerojnë bashkëpunimin e tyre për të mbuluar edhe fusha të tjera të aktiviteteve kriminale.

Neni 2

Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë në parandalimin, zbulimin dhe luftimin e krimit të organizuar me këto mënyra:

a) shkëmbim i ndërsjellë i informacionit dhe i të dhënave në fushat e përmendura në nenin 1, veçanërisht për personat dhe grupet që marrin pjesë në kryerjen e krimeve të përmendura në nenin 1 apo personave që dyshohen se kanë marrë pjesë; lidhjet e autorëve të veprave penale, organizatës dhe strukturës së grupit të organizuar; metodat tipike të shkelësve individualë dhe grupeve; fakteve të lidhura me kohën, vendndodhjen dhe mënyrën e kryerjes së krimeve; objektet që përbëjnë objektivat e krimeve; rrethanave specifike; shkeljes së akteve; mbi masat e marra për të parandaluar dhe penguar kryerjen e krimeve të tilla;

b) marrja e masave të përbashkëta mbi bazat e marrëveshjes së përbashkët të të dyja Palëve Kontraktuese dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe shteteve të Palëve Kontraktuese;

c) bashkëpunimi në kërkim të personave të dyshuar për kryerjen e krimeve apo të personave që arratisen për t'iu shmangur përgjegjësisë penale apo kryerjes së dënimit;

d) bashkëpunimi në kërkimin e sendeve të vjedhura dhe objekteve të lidhura me krimin, duke përfshirë mjetet motorike;

e) ndihmë të ndërsjellë në sigurimin e mbrojtjes së dëshmitarit, jeta apo shëndeti i personit të afërt të të cilit/cilës në lidhje me dëshminë e tij/të saj apo dorëzimit të provave i ekspozon para kërcënimit;

f) shkëmbimi i ekspertëve dhe zhvillimi i stërvitjeve të përbashkëta, seminareve dhe trajnimeve;

g) shkëmbim informacioni mbi rezultatet e kërkimeve të tyre kriminologjike dhe kriminale, mbi teknikat e hetimit dhe aplikimit të metodave dhe pajisjeve me synimin për t'i përmirësuar ato;

h) sipas kërkesës, shkëmbimi i informacionit ose mostrave të objekteve të përdorura në kryerjen e krimeve apo që rezultojnë nga aktiviteti kriminal;

i) shkëmbimi i materialeve analitike dhe konceptuale në lidhje me krimin e organizuar.

Neni 3

1. Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë për të luftuar krimet e përmendura në nenin 1 në këtë Marrëveshje dhe do të sigurojnë ndihmë edhe në mënyrat e mëposhtme:

a) Shkëmbim të ndërsjellë përvoje dhe teknologjish në fushën e mbrojtjes së të dhënave të rrjeteve kompjuterike.

b) Shkëmbim i ndërsjellë i akteve normative, shkencore, botimeve arsimore dhe të specializuara të lidhura me luftën kundër krimit.

2. Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë vetëm në lidhje me aktet që përbëjnë vepra penale në përputhje me legjislacionin kombëtar të dy shteteve të Palëve Kontraktuese.

3. Bashkëpunimi në përputhje me këtë Marrëveshje nuk do të ndikojë në ndihmën ligjore, e cila shtrihet nën kompetencën e autoriteteve gjyqësore.

Neni 4

1. Secila Palë Kontraktuese mund të atashojë për një periudhë të kufizuar kohore oficerin ndërlidhës për autoritetet policore apo autoritete të tjera përgjegjëse për parandalimin, zbulimin dhe luftën ndaj krimit për Palën tjetër Kontraktuese ose për misionin e saj diplomatik në territorin e Shtetit të Palës tjetër Kontraktuese.

2. Qëllimi i atashimit të oficerit të kontaktit do të jetë rritja e bashkëpunimit policor ndërmjet Palëve Kontraktuese në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, si edhe asistencë në:

a) shkëmbimin e informacionit që lidhet me parandalimin, zbulimin, qartësimin dhe luftimin e krimit.

b) përpunimin e kërkesave të natyrës kriminale.

c) sigurimin e informacionit të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të autoriteteve kompetente mbi shmangien e kërcënimeve për rendin publik, sigurinë ose interesa të tjerë të rëndësishëm të shtetit.

3. Oficeri i kontaktit do të kryejë detyrën e këshillimit dhe mbështetësit në lidhje me autoritetet e luftës kundër krimit dhe ai/ajo nuk ka të drejtë për të kryer individualisht veprime në mënyrë që të parandalojë dhe luftojë krimin.

4. Oficeri i kontaktit do të kryejë aktivitetet e tij/saj në zbatim të rregullave të Palës Kontraktuese dërguese.

Neni 5

Për të garantuar mbrojtjen e të dhënave personale dhe ndonjë transmetim informacioni ndërmjet Palëve Kontraktuese, mbrojtjet do të kryhen në përputhje me legjislacionin kombëtar të shteteve të Palëve Kontraktuese dhe sipas kushteve të mëposhtme:

a) Pala pritëse Kontraktuese mund të përdorë të dhëna të tilla vetëm për qëllimin dhe sipas kushteve të përcaktuara nga Pala Kontraktuese dërguese.

b) Pala Kontraktuese pritëse, sipas kërkesës së Palës Kontraktuese dërguese, do të sigurojë informacion për përdorimin e informacionit të transmetuar dhe për rezultatet e arritura në këtë mënyrë.

c) Të dhënat personale mund të transmetohen ekskluzivisht tek autoritetet kompetente për të luftuar krimin; asnjë e dhënë nuk do të vihet në dispozicion të autoriteteve të tjera pa lejen me shkrim të marrë paraprakisht nga Pala Kontraktuese dërguese.

d) Pala Kontraktuese dërguese do të jetë përgjegjëse për sasinë e informacionit të transmetuar dhe do të konstatojë nëse një transferim i tillë është i nevojshëm dhe i përshtatshëm; në rast se konstatohet se janë transmetuar të dhëna të pasakta ose të dhënat nuk duhej të ishin transmetuar, Pala Kontraktuese pritëse do të njoftohet menjëherë për këtë; Pala Kontraktuese pritëse ose do të korrigjojë gabimet, ose do të shkatërrojë të dhënat që nuk duhet të transmetoheshin.

e) Ndonjë person, të dhënat personale të të cilit duhen të ose janë transmetuar, do të ketë të drejtë, me kërkesën e tij/saj, të marrë informacion mbi të dhënat e transmetuara dhe qëllimin e përdorimit të tyre, me kusht që kjo të jetë e pranueshme sipas legjislacionit kombëtar të shteteve të dy Palëve Kontraktuese.

f) Në çdo rast, kur transmetohen të dhëna, Pala Kontraktuese dërguese do të njoftojë Palën Kontraktuese pritëse për afatin kohor të shkatërrimit të të dhënave në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar; pavarësisht afatit të tillë kohor, të gjitha të dhënat që lidhen me personin në fjalë do të shkatërrohen sapo ruajtja e tyre nuk do të jetë më e nevojshme; Pala Kontraktuese dërguese do të njoftohet për shkatërrimin e të dhënave të transmetuara dhe arsyet për këtë; në përfundim të kësaj Marrëveshjeje, të gjitha të dhënat e marra pas këtij momenti do të shkatërrohen.

g) Palët Kontraktuese do të kenë për detyrë të mbajnë regjistrime të transmetimit, vërtetim dhe shkatërrim të të dhënave.

h) Palët Kontraktuese do të kenë për detyrë të mbrojnë në mënyrë efektive të dhënat personale të transmetuara gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

Transmetimi i informacionit të klasifikuar në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe mbrojtja e tyre do të kryhet në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të

Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Sllovake mbi Mbrojtjen e Ndërsjellë të Informacionit të Klasifikuar, të nënshkruar në Tiranë më 18 qershor 2009.

Neni 7

1. Pala Kontraktuese e kërkuar mund të refuzojë, tërësisht ose pjesërisht, ekzekutimin e aplikimit për bashkëpunim ose asistencë nëse ekzekutimi i një aplikimi të tillë mund të paraqesë kërcënim për sovranitetin, sigurinë ose ndonjë interes tjetër të rëndësishëm të shtetit të tij, ose nëse ekzekutimi i një aplikimi të tillë mund të jetë në kundërshtim me legjislacionin kombëtar të shtetit të tij ose të angazhimeve që rrjedhin nga traktatet ndërkombëtare.

2. Pala Kontaktuese e kërkuar do të njoftojë pa vonesë Palën Kontraktuese kërkuese për refuzimin e ekzekutimit të aplikimit ose ekzekutimit të tij të pjesshëm.

Neni 8

1. Bashkëpunimi operativ dhe i drejtpërdrejt sipas kësaj Marrëveshjeje do të kryhet nga autoritetet kompetente të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës Sllovake, të cilët do të kenë kompetenca, nëse është e nevojshme, të nënshkruajnë protokolle zbatimi.

2. Palët Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, brenda kohës më të shkurtër të mundshme pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, për autoritetet kompetente të përmendura në paragrafin 1, përfshirë adresat e tyre të personave të kontaktit, numrat e telefonave dhe fakseve; dhe do të njoftojnë menjëherë njëri-tjetrin për ndonjë ndryshim të këtyre të dhënave.

3. Nëse nuk është rënë dakord ndryshe për ndonjë rast të veçantë, informacioni i shkëmbyer nëpërmjet autoriteteve kompetente do të kryhet në gjuhën angleze.

Neni 9

Kjo Marrëveshje nuk do të ndikojë tek ndonjë detyrim i shteteve të Palëve Kontraktuese, në të cilat këto shtete janë lidhur nëpërmjet një marrëveshjeje të vlefshme bilaterale ose multi-laterale.

Neni 10

1. Shpenzimet e kryera në lidhje me zbatimin e bashkëpunimit sipas kësaj Marrëveshjeje do të mbulohen nga Palët Kontraktuese mbi baza të parimit të reciprocitetit, nëse nuk bihet dakord ndryshe nga Palët Kontraktuese.

2. Shpenzimet në lidhje me shkëmbimin e ekspertëve do të përballohen, si më poshtë: Kostot e udhëtimit ndërkombëtar do të mbulohen nga Pala Kontraktuese dërguese dhe shpenzimet për kostot e udhëtimit të brendshëm, ushqimi dhe akomodimi do të përballohen nga Pala Kontraktuese pritëse.

Neni 11

1. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me anë të konsultimeve ndërmjet autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese. Në rast të mungesës së rezultatit, mund të zgjidhet nëpërmjet kanaleve diplomatike.

2. Kjo Marrëveshje mund të modifikohet dhe ndryshohet në bazë të pëlqimit me shkrim nga të dyja Palët Kontraktuese.

Neni 12

1. Kjo Marrëveshje nënshkruhet për një periudhë të pacaktuar kohe dhe do të hyjë në fuqi ditën e 90-të pas datës së marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, sipas të cilit Palët Kontraktuese do të njoftojnë njëri-tjetrin, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për plotësimin e kushteve të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi, në përputhje me legjislacionin kombëtar.

2. Secila Palë Kontaktuese mund ta përfundojë këtë Marrëveshje nëpërmjet kanaleve diplomatike, në formë të shkruar. Në këtë rast, kjo Marrëveshje do të pushojë së pasuri fuqi 3 (tre) muaj pas ditës së marrjes së njoftimit të përfundimit nga pala tjetër.

Nënshkruar në ..... më .....:..... 2015 në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, gjuhën sllovake dhe gjuhën angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast të ndonjë mosmarrëveshje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

VENDIM
Nr. 487, datë 10.6.2015

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 513, DATË 13.6.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE E TË DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 30, të ligjit nr. 108/2013, "Për të huajt", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në aneksin nr. 3, "Lista e shteteve, shtetasit e të cilëve hyjnë pa viza në Republikën e Shqipërisë dhe çfarë dokumenti duhet të paraqesin", bashkëlidhur vendimit, të shtohen fjalët "...Arabia Saudite, Katari, Omani, Bahrejni, Rusia, Gjeorgjia, Bjellorusia, me dokumentin pasaportë, për periudhën 1 qershor - 1 nëntor 2015...".

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 488, datë 10.6.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1 dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutës së Këshillit të Sigurimit ("Lista e OKB-së"), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës "C", "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", çregjistrohet individi i renditur në shkronjën "a", të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas ndryshimeve në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatës Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT ("LISTA E OKB-së")

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN AL-QAIDA

a) Lista e ndryshuar në "**Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida";**

1. ABDUL RAHIM; AL-TALHI.

Shënim: Gjeneralitet e tjera për personin, emri i të cilit është radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

VENDIM
Nr. 495, datë 10.6.2015

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E DREJTËSISË, TË PRONËS NR. 139, ME EMËRTIM "REPARTI USHTARAK NR. 8890, OBJEKTE B130", ME VENDNDODHJE NË MËZES, TIRANË, TË DISA OBJEKTEVE E TË NJË SIPËRFAQEJE TRUALLI FUNKSIONAL, BRENDA TERRITORIT TË PRONËS NR. 109, ME EMËRTIM "SHA, RIPARIM ARTILERIE", ME VENDNDODHJE NË BRAR, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, QË I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Drejtësisë, të pronës nr. 139, me emërtim "Reparti Ushtarak nr. 8890, Objekte b130", me vendndodhje në Mëzes, Tiranë, të disa objekteve dhe të një sipërfaqeje trualli funksional, me sipërfaqe të përgjithshme (S1) prej 13 236 (trembëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë) m^2, brenda territorit të pronës nr. 109, me emërtim "SHA, Riparim Artilerie", me vendndodhje në Brar, Tiranë, sipas planvendosjeve që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, për t'u përdorur për plotësimin e nevojave institucionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

2. Prona nr. 139, me emërtim "Reparti Ushtarak nr. 8890, Objekte b130", me vendndodhje në Mëzes, Tiranë, si dhe objektet e sipërfaqja truall funksional, me sipërfaqe të përgjithshme (S1) prej 13 236 (trembëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë) m^2, brenda territorit të pronës nr. 109, me emërtim "SHA, Riparim Artilerie", me vendndodhje në Brar, Tiranë, të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe të shtohen në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

3. Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e pronave, të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, t'i tjetërsojnë ato apo t'ua japin në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Drejtësisë, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Plan vendosja e prones nr.139 "Rep.Usht.Nr.8890,Objekte b 130"Mëzes,Tirane.
Sip. dhe objektet që kerkohen për kalim nga
Ministria e Mbrojtjes në administrim te Ministrisë së Drejtësis.

Sistemi i koordinatave shteterore



Shenim-Kjo planvendosje u hartua sipas dokumentacionit teknik të marrë nga arkivi i I.GJ.U-së dhe në zbatim te shkreses me nr.3631/1 dt.05-05-2015,të SHSHPFA.

Ripunuar Majë 2015.

Miratohet
Komandanti i Komandës Mbështetese
Gjeneral Brigade Ylber DOGJANI



Shpjeguese.

Sip. e përgjithëshme = 89530.35 m2
Sip. me ndërtime = 2269.79 m2
ne sip. e ndertimit nuk eshte perfshire
depo kimise tip tunel
Kufiri i repartit

Shenim-Kjo planvendosje u hartua sipas dokumentacionit teknik të marrë nga arkivi i I.GJ.U-së dhe në zbatim te shkreses me nr.3631/1 dt.05-05-2015,të SHSHPFA.

4 579 Ripunuar Majë 2015.

200
4 395 200 395 450 395 650

Shkalla 1:2500

Ripunoi
Ing:Albert MURATI

DREJTOR I I.GJ.I.U-së
N/Kol Zydi ALCANI

Pergj.Sek. Ramiz HAXHIU

Plan vendosja e prones nr.109 SHA Riparim Artilerie Brar,TIRANE.
Sip. dhe objektet që kerkohen për kalim nga
Ministria e Mbrojtjes në administrim te Ministrisë së Drejtësis.

stemi i koordinatave shteterore

584 000

583 950

583 700

4 583 450

4 404 700 404 950 405 150 405 200

Miratohet
Komandanti i Komandës Mbështetse
Gjeneral Brigade Ylber DOGJANI



Shpjeguese prona109

Sip e pergjithshme = 43169.2 m2
Kufiri i repartit

Sip S1 = 13236.0 m2 sip.qe kërkohet për kalim në administrim nga MM, për Ministrin e Drejtësis, bashkë me Objektet me nr.(19,20,27,28,28/1,29,30,31,32.)

Sip S3 = 11754.2 m2 (sip dhënë ne administrim te Ministrise se Kultures "TKOBAP".)

Sip S2 = 18179 m2 (sip.dhënë ne administrim te DPA).

Shenim-Kjo planvendosje u hartua sipas dokumentacionit teknik të marrë nga arkivi i I.GJ.U-së dhe në zbatim te shkreses me nr.3631/1 dt.05-05-2015,të SHSHPFA.

Ripunuar Majë 2015.

Shkalla 1:2500

Ripunoi
Ing:Albert MURATI

DREJTOR I I.GJ.I.U-
N/Kol Zydi ALCAN

VENDIM
Nr. 496, datë 10.6.2015

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, PËR PREFEKTIN E QARKUT TË TIRANËS DHE ADMINISTRATËN E TIJ, TË GODINËS QENDRORE TË SHËRBIMIT GJEOLOGJIK SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për prefektin e Qarkut të Tiranës dhe administratën e tij, të godinës qendrore të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, sipas planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për t'u përdorur për mjedise pune.

2. Prefektit të qarkut të Tiranës nuk i lejohet tjetërsimi, ndryshimi i destinacionit ose dhënia në përdorim të tretëve e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, prefekti i Qarkut të Tiranës dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama




Planimetria e bodrumit te Godines Qendrore te Sh.Gj.Sh Rr.Kavajes Tirane
17.50
3.50
4.50
7.50
1.20
1.60
2.90
2.00
3.10
2.00
1.50
2.00
1.20
1/0/3
S=15.75m2
2/0/3
S=20.25m2
3/0/3
S=33.75m2
4/0/3
S=17.50m2
5/0/3
S=8.52m2
6/0/3
S=31.37m2
7/0/3
S=13.10m2
4.50
5.00
1.50
2.00
4.50
11.00
2.00
2.62
3.50
1.20
5.82
5.00
Siperfaqa e bodrumit 187m2


Planimetria e katit te I te Godines Qendrore te Sh.Gj.Sh Rr. Kavajes Tirane
1/1/3
Ambjent i Arkivit Teknik
S=11.17m2
2/1/3
Zyre Studimi
S=11.96m2
Koridor
S=5.65m2
WC
S=5.80m2
Koridor
S=9.35m2
Magazine Rikupero
S=8.70m2
3/1/3
Zyre Personeli 2 Punonjesa
S=15.66m2
Koridor
S=5.58m2
Koridor
S=5.10m2
4/1/3
Zyre e Nenpunesit Sherbimit
S=8.10m2
WC
S=5.93m2
Koridor
S=7.55m2
5/1/3
Salla e Aktivileteve te Sh.Gj.Sh
S=41.91m2
WC
S=1.95m2
Aneks
S=4.05m2
6/1/1
Magazina e Gjeologjise Detare
S=18.27m2
7/1/1
Magazina Qendrore Nr.1 e Sh.Gj.Sh 1 Punonjes
S=19.95m2
8/1/1
Zyra me Dokumenta te Ministrise se Energjise
S=19.32m2
Kjoske
Siperfaqa e zyrave katit te pare 290m2
Tirane. 26.01.2015 Punoi: Ing. Afrim Nelaj


Planimetria e katit te II te Godines Qendrore te Sh.Gj.Sh Rr. Kavajes Tirane
1/2/3
Ambjent i Arkivit Teknik
S=18.29m2
2/2/3
Ambjent i Arkivit Teknik
S=20.22m2
3/2/3
Ambjent i Arkivit Teknik
S=27.75m2
4/2/3
Ambjent i Arkivit Teknik
S=17.29m2
7/2/3
Sekretaria
S=15.81m2
Koridor
S=8.83m2
8/2/3
Zyre e Nendrejtorit te Pergjithshem i Sh.Gj.Sh
S=24.55m2
S=5.00m2
Koridor
S=1.98m2
Koridor
S=1.73m2
Koridor
S=13.06m2
Koridor
S=2.17m2
Koridor
S=5.27m2
9/2/3
Zyre e Drejtorit te Pergjithshem te Sh.Gj.Sh
S=42.26m2
5/2/3
Zyre Personeli 2 Punonjes
S=17.40m2
Koridor
S=5.53m2
6/2/3
Ambjent i Arkivit Teknik
S=16.52m2
WC
S=7.65m2
Koridor
S=2.20m2
Fotokopja
S=3.20m2
Koridor
S=4.58m2
Siperfaqa e zyrave kati i dyte 353m2
Tirane. 26.01.2015 Punoi: Ing. Afrim Nelaj


Planimetria e katit te III te Godines Qendrore te Sh.Gj.Sh rr. Kavajes
1/3/3
Zyre Personeli 2 Punonjes
S=18.09m2
2/3/3
Zyre e Drejtorit te Gjeoinformacionit
S=20.22m2
3/3/3
Zyre e Arkivit Administrativ
S=13.71m2
4/3/3
Zyre e Drejtorit te Finances dhe Sherbimeve
S=13.25m2
5/3/3
Zyre Personeli 2 Punonjes
S=17.76m2
6/3/3
Zyre Personeli 2 Punonjes
S=15.81m2
7/3/3
Zyre Personeli 4 Punonjes
S=34.78m2
S=2.30m2
Koridor
S=7.17m2
Koridor
S=24.34m2
Koridor
S=6.12m2
Koridor
S=8.25m2
Serveri i Internetit
S=3.92m2
8/3/3
Zyre Personeli 2 Punonjes
S=16.08m2
9/3/3
Zyre Personeli 2 Punonjes
S=10.90m2
10/3/3
Zyrre Personeli 1 Punonjes
S=10.53m2
WC
S=4.40m2
WC
S=4.40m2
Mag. Sanitares
S=4.43m2
Koridor
S=3.47m2
11/3/3
Zyre e Drejtorit te Programim Zhvilimit
S=10.35m2
12/3/3
Zyre Personeli 2 Punonjes
S=16.15m2
Siperfaqa e zyrave kati i trete 338m2
Tirane. 26.01.2014 Pumoi: Ing. Afrim Nelaj

VENDIM
Nr. 499, datë 10.6.2015

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, SI QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË "MSP TRADE CONCEPT", SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË "ISH-NPV Nr. 2, DURRËS" NË "NPV", SHA, DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës, dhe shoqërisë "M.S.P. Trade Concept", sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë "Ish-NPV nr. 2, Durrës", në "NPV", sh.a., Durrës, me sipërfaqe të përgjithshme 7 132 (shtatë mijë e njëqind e tridhjetë e dy) m^2, nga ku sipërfaqe ndërtimore 4 240 (katër mijë e dyqind e dyzet) m^2, sipas genplanit objekt nr. 1 (3 kate), 4 082 (katër mijë e tetëdhjetë e dy) m^2 + objekt nr. 1/a , 7 (shtatë) m^2 + objekt nr. 1/b, 3 (tre) m^2 + objekt nr. 2, 126 (njëqind e njëzet e gjashtë) m2 + objekt nr. 3, 22 (njëzet e dy) m^2, si dhe sipërfaqe funksi-onale 2 892 (dy mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e dy) m^2.

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama




Harta Kadastrale
PERGATITI
Emri Hidro Kons Studio
Licensa Nr: N.6894/1 Date: 03/02/2015
Data e pergatitjes 25/02/2015
Vula/Firma
IDENTIFIKIMI I PASURISE
ZONA KADASTRALE 8513
NR.I PASURISE 1/147,116,153 VOL. FQ
INDEKSI I HARTES DR-FQ-4,5
SHKALLA 1:1000
ADRESA E PASURISE: Rrethi Durres
Q/Y Durres Rr/L A. Gaga/18
P/G Sh K Ap
PRONARI SHA "NPV" Durres
Per SHA "NPV" - Durres
Administratori
Gezim Gulaj
AUTORITETI KONTRAKTOR:
SHA "NPV" Durres
STUDIO PROJEKTUESE:
HIDRO KONS STUDIO sh.p.k.
Emertimi i fletes: Harta kadastrale
Emertimi i projektit: PLAN RILEVIMI, GENPLAN, PLANIMETRIA E NDERTESES
Data
Shkalla
25/02/2015
1:1000
N-05


Objekti Nr.1 , 1/a; 1/b, PLANIMETRIA E KATIT PERDHE , "Magazinim dhe Paketim" , SH 1 : 200
Sip. kati =1262 m²
Per SHA "N.P.V" - DURRES
Administratori
Gezim GULAJ
AUTORITETI KONTRAKTOR:
SHA "NPV" Durres
STUDIO PROJEKTUESE:
HIDRO KONS STUDIO sh.p.k.
Emertimi i projektit: PLAN RILEVIMI, GENPLAN, PLANIMETRIA E OBJEKTIT
Data
Shkalla
25/02/2015
1:200
N-06


Objekti Nr.1 , PLANIMETRIA E KATIT TE PARE , "Reparti i Prodhimit" , SH 1 : 200
Sip. kati =1410 m²
Per SHA "N.P.V" - DURRES
Administratori
Gezim CULAJ
AUTORITETI KONTRAKTOR:
SHA "NPV" Durres
STUDIO PROJEKTUESE:
HIDRO KONS STUDIO sh.p.k.
Data
Rev.No.
Paraleximi i ndryshimit
Projektoi
Emertimi i fletes: Objekti Nr.1 , Planimetria e katit te
Emertimi i projektit: PLAN RILEVIMI, GENPLAN, PLANIMETRI E OBJEKTIT
Data
Shkalla
Numri- Vizatimit
25/02/2015
1:200
N-07


Objekti Nr.1 , PLANIMETRIA E KATIT TE DYTE , "Prestari dhe Hekurosje" SH 1 : 200
Sip. kati =1410 m²
Per SHA "N.P.V" - DURRES
Administratori
Gezim CULAJ
AUTORITETI KONTRAKTOR:
SHA "NPV" Durres
STUDIO PROJEKTUESE:
HIDRO KONS STUDIO sh.p.k.
Data
Rev.No.
Paraleximi i ndryshimit
Projektoi
Firma
Emertimi i fletes: Objekti Nr.1 , Planimetria e katit te dyte
Emertimi i projektit: PLAN RILEVIMI, GENPLAN, PLANIMETRI E OBJEKTIT
Data
Shkalla
Numri- Vizatimit
25/02/2015
1:200
N-08



VENDIM
Nr. 500, datë 10.6.2015

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 887, DATË 21.12.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË DOKUMENTIT NDRYSHUES TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË GREQISË, PËR PROGRAMIN DYPALËSH TË NDIHMËS SË BASHKËPUNIMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121 e 124, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shfuqizimin e vendimit nr. 887, datë 21.12.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin, në parim, të dokumentit ndryshues të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, për programin dypalësh të ndihmës së bashkëpunimit".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 501, datë 10.6.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE: NR. 1481, DATË 12.11.2008; NR. 1657, DATË 24.12.2008; NR. 100, DATË 27.1.2009; NR. 286, DATË 18.3.2009; NR. 450, DATË 6.5.2009; NR. 611, DATË 11.6.2009; NR. 677, DATË 18.6.2009; NR. 706, DATË 23.6.2009; NR. 805, DATË 22.7.2009; NR. 1038, DATË 14.10.2009; NR. 1134, DATË 18.11.2009; NR. 1283, DATË 23.12.2009; NR. 125, DATË 17.2.2010; NR. 247, DATË 13.4.2010; NR. 404, DATË 26.5.2010; NR. 549, DATË 7.7.2010; NR. 646, DATË 28.7.2010, NR. 118, DATË 7.2.2011; NR. 359, DATË 4.5.2011; NR. 822, DATË 23.11.2011; NR. 513, DATË 1.8.2012; NR. 61,

DATË 23.1.2013; NR. 686, DATË 16.8.2013; NR. 345, DATË 24.4.2013; NR. 713, DATË 19.10.2014; NR. 279, DATË 1.4.2015, TË NDRYSHUARA, PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË PRONËSISË SË DISA PARCELAVE NDËRTIMORE NË FAVOR TË POSEDUESVE TË OBJEKTEVE INFORMALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, të shkronjës "ç", të nenit 4, të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995, "Për shitblerjen e trojeve", të ndryshuar, dhe të nenit 163, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimet nr. 1481, datë 12.11.2008; nr. 1657, datë 24.12.2008; nr. 100, datë 27.1.2009; nr. 286, datë 18.3.2009; nr. 450, datë 6.5.2009; nr. 611, datë 11.6.2009; nr. 677, datë 18.6.2009; nr. 706, datë 23.6.2009; nr. 805, datë 22.7.2009; nr. 1038, datë 14.10.2009; nr. 1134, datë 18.11.2009; nr. 1283, datë 23.12.2009; nr. 125, datë 17.2.2010; nr. 247, datë 13.4.2010; nr. 404, datë 26.5.2010; nr. 549, datë 7.7.2010; nr. 646, datë 28.7.2010, nr. 118, datë 7.2.2011; nr. 359, datë 4.5.2011; nr. 822, datë 23.11.2011; nr. 513, datë 1.8.2012; nr. 61, datë 23.1.2013; nr. 686, datë 16.8.2013; nr. 345,datë 24.4.2013; nr. 713, datë 19.10.2014; nr. 279, datë 1.4.2015, të ndryshuara, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë, për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 13/208, 9/822, 34/144, 5/150, 26/95 dhe 18/80, në drejtoritë e ALUIZNI-t Tiranë 1, Durrës, Tiranë 3 dhe Vlorë, të jenë sipas lidhjes A, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 12/29, 8/58, 8/28, 3/1, 3/79, 8/46, 27/212, 11/39, 12/15, 5/22, 2/27, 8/51, 12/321, 19/227, 13/227, 13/294, 12/258 dhe 29/72, në drejtoritë e ALUIZNI-t Elbasan dhe Vlorë, të jenë sipas lidhjes B, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 4/604, 6/12, 2/44, 162/44, 10/296, 14/4, 14/12, 13/49, 10/5, 13/5, 13/6, 11/72, 9/11, 11/20, 303/51, 183/10, 168/5, 157/3, 263/1, 168/12, 303/2, 162/38, 26/142, 22/258, 18/291 dhe 26/143, në drejtoritë e ALUIZNI-t Tiranë 1, Elbasan dhe Vlorë, të jenë sipas lidhjes C, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 10/86 dhe 12/108, në Drejtorinë e ALUIZNI-t Elbasan, të jenë sipas lidhjes E, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 4/499, 4/342, 4/608, 3/593, 16/355, 13/61, 7/6, 17/1, 90/23, 90/24, 30/17, 30/16, 79/5 dhe 28/294, në drejtoritë e ALUIZNI-t Tiranë 1, Elbasan dhe Vlorë, të jenë sipas lidhjes F, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 1/343, 6/553, 9/156, 1/384, 9/247, 5/463, 6/665, 5/245, 5/385, 13/252, 14/34, 5/315, 5/272, 4/297, 5/302, 2/173 dhe 25/65, në drejtoritë e ALUIZNI-t Tiranë 1, Tiranë 2 dhe Vlorë, të jenë sipas lidhjes G, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 8/874, 6/669, 6/734, 6/405, 8/771, 4/315, 3/617, 8/579, 8/903, 3/535, 8/885, 8/818, 3/576, 4/281, 12/279 dhe 6/238, në drejtoritë e ALUIZNI-t Tiranë 1 dhe Elbasan, të jenë sipas lidhjes H, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 14/391, 8/403, 4/434, 15/481, 13/623, 2/425, 11/602, 4/394, 400/5, 1/198, 11/204, 11/205, 11/612, 8/359, 1/215, 8/404, 10/433, 400/256 dhe 400/461, në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tiranë 1, të jetë sipas lidhjes I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat

ndërtimore me nr. pasurie 8/405, 13/725, 4/382, 8/409, 14/399, 10/225, 4/287, 31/185, 22/370, 31/200 dhe 33/413, në drejtoritë e ALUIZNI-t Tiranë 1 dhe Vlorë, të jenë sipas lidhjes J, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

10. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 7/272, 9/1463, 8/1077, 8/1037, 8/884, 5/306, 5/421, 6/786 dhe 7/466, në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tiranë 1, të jetë sipas lidhjes K, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

11. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 19/125, 65/209, 2/358, 46/66, 46/101, 46/81 dhe 46/71, në drejtoritë e ALUIZNI-t Tiranë 3, Tiranë 2 dhe Vlorë, të jenë sipas lidhjes L, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

12. Gjenealiteti i poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 5/581 dhe 1/747, në drejtoritë e ALUIZNI-t Tiranë 1 dhe Shkodër, të jenë sipas lidhjes M, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

13. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 8/1278, 11/578, 4/226, 51/135 dhe 51/321, në drejtoritë e ALUIZNI-t Tiranë 1, Tiranë 2 dhe Tiranë 3, të jenë sipas lidhjes N, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

14. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 9/261, 31/47, 15/324, 36/157, 19/247, 38/223, 15/325, 15/319 dhe 38/220, në drejtoritë e ALUIZNI-t Tiranë 1 dhe Elbasan, të jenë sipas lidhjes O, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

15. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 8/1209, 8/1336, 8/1355, 5/293, 5/294, 8/107, 5/15, 1/39, 5/289 dhe 5/303, në drejtoritë e ALUIZNI-t Tiranë 1 dhe Kukës, të jenë sipas lidhjes P, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

16. Gjenealiteti i poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 5/673, 2/61, 2/62, 5/288, 5/300, 6/13, 6/257, 6/262 dhe 1/68, në drejtoritë e ALUIZNI-t Kukës dhe Shkodër, të jenë sipas lidhjes Q, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

17. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 7/203, 7/276, 7/443, 4/336, 2/406, 8/172, 4/652, 7/522, 400/1515, 8/919, 2/618, 4/219, 8/135, 8/129, 8/116, 11/12 dhe 11/99, në drejtoritë e ALUIZNI-t Tiranë 1 dhe Elbasan, të jenë sipas lidhjes R, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

18. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 4/700, 10/114, 4/198, 10/78, 10/79, 10/80, 10/81 dhe 11/131, në drejtoritë e ALUIZNI-t Tiranë 1, Durrës dhe Kukës, të jenë sipas lidhjes S, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

164	20132	15.06.2009	Gjon	Preka	Zef	Roze	29.05.1931	Shkodër	M	04.07.1954	5840000	200000	720000	0	0	4920000
165	20133	15.06.2009	Rizah	Shehu	Asllan	Baftije	27.01.1948	Kukës	M	20.11.1967	5840000	200000	720000	0	0	4920000
166	20147	15.06.2009	Majlind	Barbullushi	Çesk	Luçije	21.05.1958	Shkodër	M	12.08.1980	5840000	200000	720000	0	0	4920000
167	20184	16.06.2009	Ndue	Rrukaj (Rrikaj)	Fran	Dikë	10.02.1913	Malësi e Madhe	M	02.09.1946	5840000	200000	1122411	0	0	4517589
168	20236	17.06.2009	Kamber	Muçaj	Beqir	Xheka	1890	Vlorë	M	30.11.1944	5840000	200000	720000	0	0	4920000
169	20268	19.06.2009	Dalip	Zuna	Jahe	Hike	10.11.1895	Sohodoll	M	01.05.1945	5840000	100000	720000	0	0	5020000
170	20282	19.06.2009	Ali	Limaja	Hasan	Sabrije	07.09.1917	Burgajet, Mat	M	05.05.1948	5840000	200000	720000	0	0	4920000
171	20290	22.06.2009	Sali	Dervishi	Jusuf	Ahmedije	02.01.1919	Dibër (Lugjej)	M	23.07.1945	5840000	200000	720000	0	0	4920000
172	20293	22.06.2009	Baba Myrteza	Kruja	Pajazit	Zyhra	01.05.1912	Krujë	M	24.05.1947	5840000	200000	800000	0	0	4840000
173	20296	22.06.2009	Murat	Shehu	Halim	Bardhe	22.05.1922	Bardhaj,Reç	M	25.01.1946	5840000	200000	720000	0	0	4920000
174	20297	22.06.2009	Halim	Shehu	Musa	Fatime	15.11.1890	Bardhaj,Reç	M	29.01.1947	5840000	200000	720000	0	0	4920000
175	20350	22.06.2009	Gjon	Shllaku	Kolë	Shaqe	01.12.1890	Shkodër	M	02.10.1957	5840000	200000	720000	1115657	0	3804343
176	20352	22.06.2009	Kol	Marku	Mark	Marije	08.05.1921	Shkodër	M	28.07.1945	5840000	200000	720000	0	0	4920000
177	20369	22.06.2009	Nikoll	Ndoi	Dedë	Dilë	30.05.1929	Lezhe	M	12.05.1950	5840000	200000	720000	0	0	4920000
178	20380	22.06.2009	Hamëz	Bilallaj (Bilali)	Rexhep	Nafize	1901	Kukës (Canaj)	M	02.02.1946	5840000	200000	720000	0	0	4920000
179	20402	24.06.2009	Zef	Kola	Kolë	Lule	12.06.1925	Theth	M	13.05.1949	5840000	200000	720000	0	0	4920000
180	20416	24.06.2009	Ali	Sejdo	Iljas	Fiqe	19.12.1920	Devoll, Korçë	M	15.05.1951	5840000	200000	720000	0	0	4920000
181	20474	24.06.2009	Dom Pjetër	Çuni	Kolë	Çile	09.07.2014	Shkodër	M	7.1948	5840000	200000	720000	0	0	4920000
182	20478	24.06.2009	Haxhi	Lika	Zenel	Shane	02.02.1917	Elbasan	M	31.12.1944	5840000	300000	720000	0	0	4820000
183	20540	25.06.2009	Perlat	Gjoleka	Shefqet	Farije	1910	Kuç Vlorë	M	04.12.1946	5840000	200000	720000	0	0	4920000
184	20619	26.06.2009	Hasan	Stajka (Stojku)	Xhafer	Fatime	06.08.1889	Elbasan	M	19.08.1952	5840000	200000	720000	0	0	4920000
185	20630	26.06.2009	Abedin	Çonga	Bektash	Sulltan	06.04.1915	Elbasan, Shemberdhenj	M	31.12.1950	5840000	200000	720000	0	0	4920000
186	20633	26.06.2009	Emin	Haxhimusaj	Xhaferr	Hedije	09.09.1903	Elbasan	M	30.04.1950	5840000	200000	720000	0	0	4920000
187	20645	29.06.2009	Hamit	Dauti	Rrahman	Bijaze	04.03.1904	Bllicë	M	10.06.1951	5840000	200000	720000	0	0	4920000
188	20670	29.06.2009	Ndue	Sokoli	Sokol	Lenë	08.07.1914	Radojë, Shkodër	M	30.01.1950	5840000	200000	720000	0	0	4920000
189	20670-A	29.06.2009	Dedë	Sokoli	Sokol	Lenë	15.05.1921	Radojë, Shkodër	M	20.03.1950	5840000	200000	720000	0	0	4920000
190	20806	29.06.2009	Ferit	Kurti	Sul	Tushe	04.07.1933	Mat	M	31.12.1948	5840000	200000	0	0	0	5640000
191	20807	29.06.2009	Hysni	Kurti	Sul	Tushe	01.01.1931	Mat	M	31.12.1948	5840000	200000	0	0	0	5640000
192	20828	29.06.2009	Islam	Duraku	Tahir	Zelfie	10.11.1927	Kukës	M	18.04.1955	5840000	200000	720000	0	0	4920000
193	20891	30.06.2009	Pader Anton	Harapi	Loro	Çië	05.01.1888	Shiroke	M	14.02.1946	5840000	200000	720000	0	0	4920000
194	20898	30.06.2009	Lesh	Përlleshi	Ndue	Mricë	01.09.1889	Musht, Pukë	M	1946	5840000	200000	720000	0	0	4920000
195	20938	30.06.2009	Ndue	Vocrri	Gjokë	Sofije	14.10.1917	Kllogjen	M	23.09.1946	5840000	200000	720000	0	0	4920000
196	20992	01.07.2009	Shefqet	Piri	Sefer	Shaje	06.01.1921	Tiranë	M	06.08.1957	5840000	200000	720000	0	0	4920000
197	21072	01.07.2009	Bajram	Tafhasaj	Liman	Tiqe	04.04.1918	Mustafaj, KUKËS	M	30.05.1947	5840000	200000	720000	0	0	4920000
198	21088	01.07.2009	Met	Saraçini	Rexhë	Sofe	19.05.1920	Tropojë	M	10.01.1945	5840000	300000	720000	0	0	4820000
199	21143	01.07.2009	Alifejzi	Kulla	Velisha	Mumazes	22.07.1924	Trestenik, Korçe	M	31.12.1945	5840000	200000	720000	0	0	4920000
200	21160	01.07.2009	Sali	Shehu	Qerim	Gjyle	31.12.1895	Bilisht	M	14.01.1945	5840000	200000	720000	0	0	4920000
201	21160-A	01.07.2009	Sheh Qerim	Shehu	Sali	Adiles	31.12.1870	Bilisht	M	14.01.1945	5840000	200000	720000	0	0	4920000

202	21188	01.07.2009	Prend	Qerimi	Qerim	Pulë	28.02.1885	Puke	M	30.04.1945	5840000	200000	720000	0	0	4920000
203	21221	01.07.2009	Shaqir	Mëzhika	Rexhep	Dushe	03.07.1903	Mat	M	10.07.1947	5840000	200000	720000	0	0	4920000
204	21302	08.04.2011	Ndue	Sokoli (Nikprendaj)	Sokol	Sykë	18.12.1916	Tropojë	M	25.09.1949	5840000	200000	720000	0	0	4920000
205	21312	08.08.2011	Mrikë	Pjetri	Lazër	Marë	1888	Mirditë	F	15.06.1945	5840000	400000	1440000	1284045	0	2715955
206	21323	08.04.2011	Lekë	Luli-Marku	Pjeter	Lene	08.03.1908	Kastrat	M	31.12.1946	5840000	200000	720000	718560	0	4201440
207	21337	08.04.2011	Ded	Hili	Vac (Voc)	Bjeshke	22.03.1922	Shkodër (Kirë)	M	29.10.1951	5840000	200000	720000	0	0	4920000
208	21347	08.04.2011	Hyrije	Gjuta	Osman	Mereme	06.07.1953	Shtiqen, Kukës	F	16.10.1974	5840000	200000	720000	0	0	4920000
209	21386	08.04.2011	Sali	Mehaj	Islam	Nazire	08.08.1943	Shkodër	M	10.06.1965	5840000	200000	720000	0	0	4920000
210	21387	08.04.2011	Ndue	Bajraktari	Preng	Dilë	18.03.1924	Domgjon, Mirditë	M	10.10.1947	5840000	200000	720000	0	0	4920000
211	21400	08.04.2011	Nikoll	Ndoj	Ded	Dilë	30.05.1929	Lezhë	M	21.05.1950	5840000	200000	720000	0	0	4920000
212	21403	08.04.2011	Ndue	Pjetri	Llesh	Mrikë	1920	Lezhë	M	22.06.1945	5840000	400000	1440000	0	1284045	2715955
213	21412	08.04.2011	Zef	Përgjini	Preng	Mrikë	01.10.1918	Lezhë	M	14.04.1952	5840000	200000	720000	0	0	4920000
214	21417	08.04.2011	Muharrem	Bakiasi	Avdyl	Sembie	20.12.1920	Skrapar	M	15.07.1945	5840000	200000	720000	0	0	4920000
215	21430	08.04.2011	Asllan	Veledi	Izeir (Yzeir)	Hajrije	1917	Delvinë	M	30.11.1944	5840000	200000	720000	0	0	4920000
216	21440	08.04.2011	Bajram	Maksuti	Sahit	Spahe	1927	Mamëz	M	13.03.1945	5840000	200000	720000	0	0	4920000
217	21450	08.04.2011	Pjetër	Gjeta	Llesh	Gjelë	31.12.1920	Bulshar, Mirditë	M	31.12.1944	5840000	200000	720000	0	0	4920000
218	21464	08.04.2011	Safet	Braçi	Abas	Bejaze	15.03.1918	Vidhan Gramsh	M	09.12.1947	5840000	200000	720000	0	0	4920000
219	21466	08.04.2011	Ndue	Ndoj	Nikolle	Dilë	08.02.1900	Fregen-Lezhe	M	29.01.1953	5840000	200000	720000	0	0	4920000
220	21484	08.04.2011	Mezan	Zejnati	Qazim	Hava	1918	Delvinë	M	10.09.1945	5840000	200000	720000	0	0	4920000
221	21485	08.04.2011	Reshat	Kulla	Qemal	Shegë	04.11.1927	Zemblak	M	13.06.1955	5840000	200000	720000	0	0	4920000
222	21498	08.04.2011	Mark	Makaj	Tomë	Luke	01.05.1903	Shkrel	M	23.01.1945	5840000	90000	716404	0	0	5033596
223	21511	08.04.2011	Koço	Laho(Lako)	Anastas	Nerënxë	23.04.1896	Kolonjë	M	10.12.1947	5840000	200000	720000	0	0	4920000
224	21512	08.04.2011	Bardhok	Gjonaj	Gjet	Gjelë	13.09.1915	Mat	M	31.12.1950	5840000	200000	720000	0	0	4920000
225	21522	08.04.2011	Ahmet	Nika	Sali	Rahime	07.07.1927	Qinamak, Kukës	M	26.04.1955	5840000	0	0	0	0	5840000
226	21523	08.04.2011	Tom	Gjelaj	Dedë	Make	04.07.1896	Lohe e Siperme	M	19.11.1946	5840000	200000	720000	0	0	4920000
227	21528	08.04.2011	Gani	Sopoti	Halil	Hasbie	16.03.1921	Brezhdan, Dibër	M	12.07.1946	5840000	200000	720000	0	0	4920000
228	21529	08.04.2011	Selman	Okaj	Hajrullah	Mejhreme	03.06.1900	Surroj, Kukës	M	20.09.1948	5840000	200000	720000	0	0	4920000
229	21532	08.04.2011	Rexhep	Sina	Abaz	Zelihe	20.03.1923	Diber	M	20.03.1945	5840000	200000	720000	0	0	4920000
230	21537	08.04.2011	Pjeter	Frroku (Nikolli, Rama)	Frrok	Dilë	02.03.1896	Rras i Eger, Pukë	M	24.04.1947	5840000	200000	0	0	0	5640000
231	21543	17.05.2011	Zef	Pjetri	Pjeter	Drande	03.11.1908	Qelëz, Pukë	M	02.09.1946	5840000	200000	930082	0	0	4709918
232	21546	17.05.2011	Ndosh	Keka	Tomë	File	20.02.1923	Pjetroshan, Shkodër	M	23.01.1955	5840000	200000	1434246	1076101	0	3129653
233	21556	17.05.2011	Prendash (Prendush)	Maçotaj	Gjergj	Dilë	04.03.1920	Lahe Siperme, Shkodër	M	01.11.1952	5840000	200000	718560	0	200000	4721440
234	21573	17.05.2011	Gjin	Nikolli	Frrok	Mrikë	13.11.1908	Rreje e Zeze, Mirditë	M	01.09.1953	5840000	200000	720000	0	0	4920000
235	21574	17.05.2011	Enver	Kruqi	Alush	Aishe	05.08.1924	Shkoder	M	01.06.1947	5840000	200000	810000	0	0	4830000
236	21577	17.05.2001	Panajot	Kuruti	Kosta	Peristera	30.02.1865	Përmet	M	03.05.1947	5840000	100000	579890	0	0	5160110
237	21591	23.04.2009	Refat	Përfundi	Sulejman	Zylkade	08.02.1910	Grabovë, Gramsh	M	Nentor 1944	5840000	200000	720000	0	0	4920000
																1159804290

VENDIM
Nr. 504, datë 10.6.2015

PËR MIRATIMIN E AUTORIZIMIT TË NDËRTIMIT TË CENTRALIT ELEKTRIK EOLIK, DHËNË SHOQËRISË "ERA MILOT", SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 2, të nenit 34/1, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e autorizimit të ndërtimit të centralit elektrik eolik, dhënë shoqërisë "Era Milot", sh.p.k., sipas tekstit dhe koordinatave të zonave të përcaktuara në hartën përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRISE

AUTORIZIM
Nr._____ datë ___.___.2015

PËR NDËRTIMIN E CENTRALIT ELEKTRIK EOLIKNGA SHOQËRIA ERA MILOT SH.P.K.

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 34/1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar dhe në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1701, datë 17.12.2008, "Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë që nuk janë objekt koncesioni", të ndryshuar,

Duke pasur parasysh se:

a) Shoqëria "Era Milot" sh.p.k. është pajisur me autorizimin paraprak nr. 1, datë 15.3.2015 nga MEI, për ndërtimin e centralit elektrik eolik në komunën Fushë Kuqe, rrethi Kurbin, qarku Lezhë;

b) "Era Milot" sh.p.k. ka paraqitur studimin e plotë të fizibilitetit teknik, ekonomik, financiar dhe mjedisor e social, bazuar në të dhëna të zonës së zbatimit të projektit;

c) "Era Milot" sh.p.k. ka paraqitur planin e biznesit të projektit;

d) "Era Milot" sh.p.k. ka paraqitur grafikun e zbatimit të projektit;

e) OST sh.a. ka miratuar pikën e lidhjes me shkresën nr. 5738/1, datë 1.10.2014;

f) "Era Milot" sh.p.k. ka marrë lejet dhe autorizimet mjedisore nga institucionet përgjegjëse;

g) "Era Milot" sh.p.k. ka paraqitur dokumentacionin që provon të drejtat e pronësisë mbi tokën që do të përdoret për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë.

Ministria e Energjisë dhe Industrisë autorizon shoqërinë "Era Milot" sh.p.k., e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, me nr. NUIS L31408009C, me seli në adresën: rruga "Sami Frashëri", nd. 14, h. 11, ap. 8, njësia bashkiake nr. 10, Tiranë, për ndërtimin e centralit elektrik eolik në përputhje me kushtet dhe karakteristikat e mëposhtme:

- Fuqi të instaluar, 36 MWp;
- Prodhimtari të pritshme totale të energjisë elektrike prej 104.400 MWh/vit;
- Numri total i kullave eolike është 12 copë;
- Kapaciteti i një turbine gjeneruese (aerogjeneratori) është 3 MW;
- Lartësia e kullës eolike është 92.5 m;
- Tipi i turbinës gjeneruese SIEMENS;
- Diametri i rotorit 113 m;
- Numri i orëve të punës në një vit rreth 3.000 orë pune;
- Shpejtësia mesatare vjetore e erës është 6.8 m/s;

Pika e lidhjes me rrjetin e transmetimit do të jetë në një çarje të linjës ajrore 110 kV Fushë-Kuqe - Laci 1, sipas skemës primare hyrje-dalje 110 kV dhe me trakte të plotë sipas standardeve IEC dhe EN, (e përcaktuar kjo në shkresën nr. DPZH/ZPT 5738/1 prot, e datës 1/10/2014, për miratimin në parim të kërkesës për rishikimin e pikës së lidhjes), përgjigje e OST-së për shoqërinë "Era Milot" sh.p.k.;

- Jetëgjatësia e pritshme e parkut eolik është 20 - 30 vjet;
- Vlera e investimit rreth 54 milion €.

1. Shoqëria "Era Milot" sh.p.k. do të përfundojë ndërtimin e centralit elektrik eolik brenda 8 muajve nga data e fillimit të punimeve.

2. "Era Milot" sh.p.k. të paraqesë në MEI projektin e plotë të zbatimit teknik brenda një periudhe prej 1 (një) muaji nga data e hyrjes në fuqi të këtij autorizimi.

3. "Era Milot" sh.p.k. është e detyruar të raportojë çdo 3 muaj pranë MEI-t mbi ecurinë e ndërtimit të centralit elektrik me erë, duke filluar nga data e fillimit të ndërtimit. MEI ka të drejtë t'i kërkojë "Era Milot" sh.p.k. çdo informacion që e konsideron të nevojshëm lidhur me zbatimin e kushteve të këtij autorizimi.

4. Brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij autorizimi, midis "Era Milot" sh.p.k. dhe MEI do të nënshkruhet një kontratë lidhur me afatet e realizimit dhe penalitetet në rast mosrealizimi në kohë apo transferimi të autorizimit.

5. "Era Milot" sh.p.k, në përputhje me VKM nr. 1701, datë 17.12.2008, "Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë që nuk janë objekt koncesioni", të ndryshuar, do t'i paguajë çdo vit ministrisë përgjegjëse për energjinë një *royalty* të barabartë me 2% të sasisë së energjisë vjetore të prodhuar nga centrali eolik ose vlerën në lekë të kësaj sasie energjie së bashku me çdo përfitim aksesor të shoqërisë në lidhje me sasinë e *royalty* prej 2% efektivisht të përfituar në bazë të incentivave të tregut të energjisë së rinovueshme.

6. Shoqërisë i rezervohet një zonë buferike me një rreze prej 50 metrash nga kufiri i centralit sipas koordinatave të zonës ku pozicionohen komponentët.

7. Autorizimi mund të revokohet nga ministria përgjegjëse për energjinë në rastet e mëposhtme:

a) Me kërkesë me shkrim të "Era Milot" sh.p.k., për raste të veçanta të justifikuara;

b) "Era Milot" sh.p.k. nuk respekton detyrimet dhe kriteret e përcaktuara në këtë autorizim dhe brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi prej ministrisë përgjegjëse për energjinë, nuk paraqet arsyet justifikuese të dokumentuara për mosrealizimin dhe nuk merr masat e nevojshme për të përmbushur detyrimet përkatëse;

c) "Era Milot" sh.p.k. nuk informon MEI mbi arsyet që mund të shpien në vonesa ndaj realizimit të ndërtimit të paktën 60 (gjashtëdhjetë ditë) përpara periudhës së përfundimit të afatit të ndërtimit;

d) Vërtetohet se deklarimet e "Era Milot" sh.p.k. nuk janë të vërteta;

e) Kur për "Era Milot" sh.p.k. kanë filluar procedurat e falimentimit ose likujdimit, sipas ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, "Për falimentimin";

f) "Era Milot" sh.p.k. për arsye të shkaktuara nga ajo vetë nuk ka respektuar programin e punimeve dhe brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi prej ministrisë përgjegjëse për energjinë, nuk paraqet arsyet për mosrealizimin e detyrës dhe nuk paraqet masat që do të ndërmarrë për të përfunduar centralin elektrik me erë në datën e përcaktuar;

g) "Era Milot" sh.p.k. nuk respekton detyrimin për informimin dhe nëse brenda një afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas njoftimit paraprak nga MEI për mosdhënie informacioni, përsëri nuk dërgon informacionin e kërkuar;

h) Në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga VKM nr. 1701, datë 17.12.2008, "Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë që nuk janë objekt koncesioni", të ndryshuar.

8. Kohëzgjatja e këtij autorizimi është 25 vjet duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij autorizimi.

9. Ky autorizim hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Ministrave.

MINISTRI I ENERGJISË DHE INDUSTRISË
Damian Gjiknuri

Aktualisht layout-ti eshte i perbere nga 12 turbina si paraqitet ne Fig. 2.3 dhe ne Tab. 2.1.



Fig. 2.3 – Layout-i i parkut eolik

WTG	UTM 34T Datum WGS 84		Koordinatat Gjeografike		Gauss Krueger (S-42 ALB)		
	X (E)	Y (N)	Lat.	Lon.	X	Y	Z
1C	385.755	4.612.708	41° 39' 30.2646" N	19° 37' 45.9461" E	4614685.331	4385838.715	1
2C	385.564	4.612.274	41° 39' 16.0974" N	19° 37' 37.9888" E	4614251.155	4385647.637	1
3C	385.931	4.611.667	41° 38' 56.6099" N	19° 37' 54.2681" E	4613643.909	4386014.786	1
4C	385.829	4.610.320	41° 38' 12.8926" N	19° 37' 50.7844" E	4612296.364	4385912.744	0
5C	385.373	4.609.993	41° 38' 2.0572" N	19° 37' 31.3053" E	4611969.232	4385456.560	0
6C	385.700	4.609.857	41° 37' 57.8173" N	19° 37' 45.5282" E	4611833.177	4385783.692	0
7C	386.115	4.613.079	41° 39' 42.4763" N	19° 38' 1.2531" E	4615056.481	4386198.860	0
8C	387.849	4.612.131	41° 39' 12.6298" N	19° 39' 16.8505" E	4614108.097	4387933.562	0
9C	387.582	4.610.571	41° 38' 21.9246" N	19° 39' 6.3646" E	4612547.465	4387666.454	0
10C	387.314	4.609.472	41° 37' 46.1628" N	19° 38' 55.5277" E	4611448.020	4387398.345	0
11C	387.370	4.608.431	41° 37' 12.4454" N	19° 38' 58.6515" E	4610406.599	4387454.368	0
12C	386.644	4.608.370	41° 37' 10.0983" N	19° 38' 27.3296" E	4610345.574	4386728.074	0

Tab. 2.1– Pozicioni i aerogjeneratoreve te parkut Eolik Milot

Seraph
Via Mons. O.A. Romero 31, 60027 S.Biagio di Osimo (An), Italy; Ph: +39 071 7202003; Fax: +39 0717202839;
seraph.srl@gmail.com; www.seraphsrl.it; P.I./C.F.-Reg.Imprese di Ancona: 02245080425; REA: 172199

VENDIM
Nr. 505, datë 10.6.2015

PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE SHPËRBLIMIN E KOMISIONEVE EPRORE TË CAKTIMIT TË AFTËSISË PËR PUNË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 39/2, pika 4, e 39/3, pika 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e komisioneve eprore mjekësore të caktimit të aftësisë për punë (më poshtë Komisioni Epror), si struktura kolegjiale mjekësore dhe ligjore, të cilat funksionojnë për shqyrtimin e ankesave të personave të interesuar lidhur me vendimet e marra nga komisionet e nivelit të parë për vlerësimin e gjendjes shëndetësore dhe të aftësive për punë, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

2. Për shqyrtimin në afat të ankesave, të ngrihen 10 komisione eprore, nga të cilat 6 komisione ushtrojnë aktivitetin dhe funksionin e tyre pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe 4 komisione ushtrojnë aktivitetin dhe funksionin e tyre pranë Shërbimit Social Shtetëror, sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Anëtari i Komisionit Epror, pas zgjedhjes në detyrë dhe përpara fillimit të ushtrimit të detyrës, betohet në një ceremoni publike, të organizuar nga ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ministri i Shëndetësisë, ministri i Financave dhe ministri i Drejtësisë, sipas tekstit të dhënë në aneksin 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

Anëtarët e komisioneve eprore, gjatë ushtrimit të mandatit të tyre në komision, nuk mund të jenë pjesë e vendimmarrjes së drejtimit të të sëmurëve, invalidëve dhe personave me aftësi të kufizuara në KMCAP-të e të dyja niveleve.

4. Kryetari i KMCAP-së epror ka për detyrë të organizojë dhe të drejtojë mbledhjen e këtij komisioni, krahas detyrave dhe përgjegjësive të tjera të ngjashme me ato të anëtarëve të KMCAP-së Epror, të cilët:

a) nuk angazhohen në detyrat e përditshme të ushtrimit të profesionit të tyre, si dhe punojnë me kohë të plotë gjatë ditëve që janë të mbledhur në Komision, pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore/Shërbimit Social Shtetëror;

b) mbajnë përgjegjësi për ruajtjen e konfidencialitetit mbi të dhënat personale të ankimuesve, për të cilat ata kanë marrë dijeni gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, mbi procesin e vlerësimit paraprak dhe të marrjes së vendimit, si dhe për votën pro ose kundër gjatë marrjes së vendimit për përcaktimin e aftësisë për punë/aftësisë së kufizuar;

c) shpërblehen sipas parashikimeve të vendimit nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore".

5. Anëtarët e komisioneve eprore ushtrojnë funksionet e tyre për:

a) shqyrtimin dhe zgjidhjen e kërkesave të të sëmurëve, invalidëve apo personave me aftësi të kufizuara, që ankimojnë vendimet e KMCAP-ve të nivelit të parë;

b) studimin dhe vlerësimin para dhe gjatë zhvillimit të seancës të relacionit të hartuar nga relatori, mjek i ekspertizës së Institutit të Sigurimeve Shoqërore/Shërbimit Social Shtetëror, duke shqyrtuar dokumentacionin mjekësor dhe ligjor të dosjes, duke kryer vizita të drejtpërdrejta të ankimuesit dhe, në raste të caktuara, edhe duke kërkuar ekzaminime të specializuara, përveç atyre të përmendura në dosje;

c) caktimin e aftësisë për punë dhe të shkallës së invaliditetit, në bazë të gjendjes shëndetësore të ankuesit dhe të kritereve mjekësore, të përcaktuara e të miratuara për nivelin e aftësisë për punë apo të aftësive shëndetësore të kufizuara, dhe marrjen e vendimit;

ç) kryerjen e studimeve mbi gjendjen dhe ecurinë e invaliditetit/aftësisë së kufizuar, drejtimet dhe zgjidhjet për përmirësimin e treguesve.

6. Procedura e ankimit kryhet, si më poshtë vijon:

a) Ankimi në Komisionin Epror bëhet me shkrim, sipas formularit tip, të dhënë në aneksin 3 bashkëlidhur këtij vendimi dhe dorëzohet pranë drejtorive rajonale të sigurimeve shoqërore /agjencive rajonale të sigurimeve shoqërore /drejtorive rajonale të Shërbimit Social Shtetëror;

b) Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore /Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror dërgon në Institutin e Sigurimeve Shoqërore/Shërbimin Social Shtetëror dosjen e të sëmurit, të invalidit ose personit me aftësi të kufizuar, së bashku me një relacion të hollësishëm, ku argumentohet vendimi i marrë nga KMCAP-ja e nivelit të parë;

c) Administrata e Institutit të Sigurimeve Shoqërore/Shërbimit Social Shtetëror njofton anëtarët e KMCAP-së Epror dhe ankimuesit, 7 (shtatë) ditë përpara zhvillimit të seancës së Komisionit Epror.

7. Mjeku i ekspertizës mjekësore/punonjësi social pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore / Shërbimit Social Shtetëror, në rolin e relatorit, studion dokumentacionin e dosjes, procedurat e zbatuara në KMCAP-në e nivelit të parë, dokumentacionin e vlerësuar nga ky Komision, pretendimet e parashtruara nga ankimuesi dhe përgatit një relacion, ku, ndër të tjera, shprehet edhe për referencën e gjendjes shëndetësore të ankimuesit, sipas kritereve mjekësore orientuese për përcaktimin e aftësisë për punë/aftësisë së kufizuar.

8. Seanca mujore e mbledhjes së Komisionit zhvillohet, si më poshtë vijon:

a) Vetëm në rastet kur janë mbledhur jo më pak se 20 dosje ankimuesish. Në çdo rast, komisionimi i ankimuesve duhet të bëhet brenda 2 (dy) muajve nga data e paraqitjes së dokumenteve në Institutin e Sigurimeve Shoqërore / Shërbimin Social Shtetëror;

b) Zhvillohet edhe me 4 anëtarë, por, në asnjë rast, nuk mund të zhvillohet në mungesë të kryetarit. Kur ka barazi në votim, në përfundim vendos vota e kryetarit;

c) Në rast se provohet mungesa me arsye e më shumë se një anëtari, atëherë njoftohet për pjesëmarrje në mbledhje zëvendësuesi respektiv, i përcaktuar për çdo Komision Epror. Kriteret dhe procedura e miratimit të anëtarëve zëvendësues është e njëjtë me kriteret dhe procedurën e anëtarëve të miratuar;

ç) Zhvillohet në ditën e caktuar nga Komisioni Epror i cili tërhiqet për të marrë vendim, pa praninë e personit.

9. Vendimet e Komisionit Epror merren me shumicë të thjeshtë votash. Anëtarët e Komisionit kanë të drejtë të argumentojnë votën e tyre pro ose kundër.

10. Në vendimin e Komisionit Epror, që plotësohet sipas formularit të caktuar, të dhënë në aneksin 3, bashkëlidhur këtij vendimi, përcaktohen:

a) diagnoza me kodin përkatës të sëmundjes;

b) shkalla e humbjes së aftësisë për punë / aftësisë së kufizuar;

c) shkaku i invaliditetit, si: sëmundje e përgjithshme, aksident në punë ose sëmundje profesionale;

ç) koha e fillimit të invaliditetit/aftësisë së kufizuar;

d) periudha e përfitimit dhe afati i rikontrollit;

dh) kushtet dhe karakteri i punës që duhet të kryejë invalidi/personi me aftësi të kufizuara;

e) masat që duhen marrë për riaftësimin e plotë fizik, si dhe drejtimet për riaftësimin profesional të invalidit/personit me aftësi të kufizuara.

11. Vendimi i Komisionit Epror arkivohet në dosjen përkatëse dhe i njoftohet me shkrim edhe ankimuesit, brenda një afati 8-ditor.

12. Nëse ankimuesit nuk paraqiten për komisionim 2 herë radhazi dhe refuzojnë të kryejnë ekzaminimet e kërkuara apo mjekimin e rekomanduar, Komisioni Epror merr vendim "pa invaliditet/pa aftësi të kufizuar", dhe dosja i kthehet Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore/Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. Në këtë rast dosja konsiderohet e mbyllur dhe për rihapjen e saj do të ndiqet procedura si për rastet që paraqiten për komisionim për herë të parë.

13. Komisioni Epror nuk mund të marrë në rishqyrtim rastet për të cilat ai është shprehur një herë, në rastet kur ankimuesi ka të njëjtën gjendje shëndetësore apo aftësi të kufizuar.

14. Efektet financiare të këtij vendimi të përballohen nga buxheti vjetor i miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe për Shërbimin Social Shtetëror.

15. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Shërbimi Social Shtetëror për zbatimin këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Aneksi 1

Emërtesat dhe specialitetet e KMCAP-eve Eprore

Nr.	KMCAP	Funksioni në KMCAP	Specialiteti
1	*Sëmundjet e Brendshme (Pneumo/Ftiziatri + Patologji) (ISSH)*	Kryetar	Pneumolog/Alergolog
2		Anëtar	Nefrolog
3		Anëtar	Reumatolog
4		Anëtar	G/Hepatologe
5		Anëtar	Jurist
6	*Kardiologji (ISSH)*	Kryetar	Kardiolog
7		Anëtar	Kardiolog
8		Anëtar	Kardiokirurg
9		Anëtar	Hipertonist
10		Anëtar	Jurist
11	*Neurologji (ISSH)*	Kryetar	Neurolog
12		Anëtar	Neurolog
13		Anëtar	Neurolog
14		Anëtar	Neurokirurg
15		Anëtar	Jurist
16	*Kirurgji (ISSH)*	Kryetar	Onkolog
17		Anëtar	Onkolog
18		Anëtar	Onkolog
19		Anëtar	Angiokirurg
20		Anëtar	Jurist
21	*Ortopedi (ISSH)*	Kryetar	Ortoped
22		Anëtar	Ortoped
23		Anëtar	Ortoped
24		Anëtar	Ortoped
25		Anëtar	Jurist
26	*Psikiatri Okulistikë (ISSH)*	Kryetar	Psikiatër
27		Anëtar	Psikiatër
28		Anëtar	Okulist
29		Anëtar	Okulist
30		Anëtar	Jurist
31	*Sëmundjet e Shëndetit Mendor (SHSSH)*	Kryetar	Psikiatër
32		Anëtar	Psikiatër
33		Anëtar	Psikiatër
34		Anëtar	Psikolog klinik
35		Anëtar	Jurist
36	*Sëmundjet e përgjithshme para moshës 21 vjeç (SHSSH)*	Kryetar	Neuropediatër - Elektrofiziolog
37		Anëtar	Nefrolog ose Internist
38		Anëtar	Endokrinolog
39		Anëtar	Kardiopediatër
40		Anëtar	Jurist
41	*Verbëri (SHSSH)*	Kryetar	Okulist
42		Anëtar	Okulist
43		Anëtar	Okulist
44		Anëtar	Okulist për fëmijë
45		Anëtar	Jurist
46	*Para dhe tetraplegjia (SHSSH)*	Kryetar	Neurokirurg
47		Anëtar	Neurokirurg
48		Anëtar	Neurolog – elektrofiziolog
49		Anëtar	Imazherist
50		Anëtar	Jurist

Aneksi 2

TEKSTI I BETIMIT

"Me të hyrë në rradhët e anëtarëve të Komisionit Epror, betohem solemnisht se:

Detyrën time do ta ushtroj me përgjegjësi dhe dinjitet.

Përkushtimi im do të jetë vlerësimi i gjendjes shëndetësore dhe shkallës së humbjes së aftësisë për punë të të sëmurit dhe invalidit.

Do të ruaj fshehtësinë për statusin e të sëmurit dhe invalidit. Do të ruaj konfidencialitetin e vendimmarrjes në Komision.

Në punën time me të sëmurët nuk do të ndikohem nga asnjë paragjykim kombëtar, racor, politik ose klasor.

Nuk do të lejoj, as në rrethana kërcënimi, që dija ime mjekësore të përdoret në kundërshtim me ligjet.

Këtë betim e bëj solemnisht dhe me vullnet të lirë, duke u mbështetur në nderin dhe ndërgjegjen time profesionale dhe njerëzore".

Formular 1 **ANEKS 3**

Nr. _____ Regjistrit Data e regjistrimit ____/____/_____

Shënim: Kjo rubrikë plotësohet nga pritësi i dokumentave në Agjencinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, pas marrjes në dorëzim të kërkesës.

Kjo ankesë do të regjistrohet në qoftë se është dorëzuar brenda 30 ditëve nga data e vendimit të KMCAP-it, të nivelit të parë.

ANKIM

KUNDËR VENDIMIT TË KMCAP-it, TË NIVELIT TË PARË

Drejtuar KMCAP-it Epror në ISSH

Depozituar në Agjencinë Lokale të Sigurimeve Shoqërore _____

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore _____

Pjesa e parë

TË DHËNA MBI GJENDJEN CIVILE

Emri _____ Datëlindja ____/_____/_____

Atësia _____ Vendbanimi _____

Mbiemri _____

Shënim: Kjo rubrikë do të plotësohet duke mbajtur parasysh regjistrimet në gjendjen civile.

Pjesa e dytë

TË DHËNA MBI VJETËRSINË NË PUNË DHE PERIUDHAT E SIGURIMIT

Deklaroj se kam këtë vjetërsi në punë dhe / ose periudha sigurimi:

Shërbim ushtarak: nga data ___/___/_____ deri në datën ___/___/_____.

Ish-kooperativë bujqësore: nga data ___/___/_____ deri në datën ___/___/_____.

Ndërmarrje / institucione: nga data ___/___/_____ deri në datën ___/___/_____.

I/E punësuar në subjektin _____, nga data ___/___/_____ deri në datën ___/___/_____.

I/E punësuar në qytet: nga data ___/___/_____ deri në datën ___/___/_____.

I/E punësuar në fshat: nga data ___/___/_____ deri në datën ___/___/_____.

Periudha të tjera të vlefshme si periudha sigurimi, sipas legjislacionit në fuqi:

Nga data ___/___/_____ deri në datën ___/___/_____.

Deklaroj se kam përfituar pagesa nga sigurimet shoqërore për:

Paaftësi të përkohëshme në punë: nga data ___/___/_____ deri në datën ___/___/_____.

Aksident në punë / sëmundje profesionale: nga data ___/___/_____ deri në datën ___/___/_____.

Papunësi: nga data ___/___/_____ deri në datën ___/___/_____.

Barrëlindje: nga data ___/___/_____ deri në datën ___/___/_____.

Të tjera: nga data ___/___/_____ deri në datën ___/___/_____.

Shënim: Rubrika Përfitime të tjera i referohet edhe përfitimeve nga skemat e tjera sociale.

Pjesa e tretë

Drejtohem për herë të parë në KMCAP me Fletë – Drejtimi nga Spitali ☐ Komisioni Mjekësor ☐ për sëmundjen _____.

KMCAP-i i rrethit _____, me Vendim nr. _____, datë ___/___/_____, më deklaroi:

a. Të aftë për punë: ☐

b. Të paaftë për punën e fundit, por i aftë për punë tjetër: ☐

c. Të paaftë për punë, por pa më njohur të drejtën për kujdestar: ☐

Me këtë vendim nuk jam dakort dhe duhet ta ankimoj në KMCAP-in Epror (brenda 30 ditëve).

Bashkëlidhur me ankesën është fotokopja e vërtetimit të KMCAP-it të rrethit.

Kërkoj që i gjithë dokumentacioni im, së bashku me ankesën, të dërgohet pranë KMCAP-it Epror.

Shënim: Kjo rubrikë plotësohet nga të sëmurët që kanë paraqitur kërkesë për pension invaliditeti për herë të parë.

Përfitoj pension invaliditeti:

a. Të plotë: ☐

b. Të plotë me të drejtë për kujdestar: ☐

c. Të pjesshëm: ☐

Për sëmundjen: _____

Nr. dosjes së pensionit: _____

Periudha e përfitimit të pensionit: nga data ___/___/_____ deri në datën ___/___/_____.

Në rikontrollin e datës ___/___/_____, KMCAP-i i rrethit, me Vendim nr. _____, më deklaroi:

a. Të aftë për punë: ☐

b. Të paaftë për punën e fundit, por i aftë për punë tjetër: ☐

c. Të paaftë për punë, por pa më njohur të drejtën për kujdestar: ☐

Me këtë vendim nuk jam dakort dhe duhet ta ankimoj në KMCAP-in Epror (brenda 30 ditëve).

Bashkëlidhur me ankesën është fotokopja e vërtetimit të KMCAP-it të rrethit.

Kërkoj që i gjithë dokumentacioni im, së bashku me ankesën, të dërgohet pranë KMCAP-it Epror.

Shënim: Kjo rubrikë plotësohet nga invalidët që nga rikontrolli nuk janë dakort me vendimin e KMCAP-it.

Shënim: Vendosni shenjën **X** brenda kutisë për deklarimet që bëni.

Ankesa përpilohet në dy kopje:

1. Kopja e parë mbahet nga Agjencia Lokale e Sigurimeve Shoqërore dhe bëhet pjesë e dosjes me dokumentacionin që dërgohet në KMCAP-in Epror;
2. Kopja e dytë mbahet nga ankuesi.

Ankuesi	Inspektori i pritjes së dokumentave
(_____)	(_____)
(Emër mbiemër)	*(Emër mbiemër)*
(_____)	(_____)
(Nënshkrimi)	*(Nënshkrimi)*
Dorëzuar në datën ___/___/_____	*Pranuar në datën ___/___/_____*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ANEKS 3

KMCAP- i EPROR _____ Formular 2

VENDIM Nr. ____

Komisioni Epror i Caktimit të Aftësisë për Punë, i mbledhur më datë ___/___/_____, pasi dëgjoi relacionin e përgatitur nga z./znj. _____, mjek I ekspertizës mjekësore pranë ISSH, shqyrtoi kërkesën dhe dokumentat e z./znj. _____, që me Vendim nr. _____, datë ___/___/_____, të KMCAP të rrethit _____, është deklaruar _____, sepse vuan nga sëmundja: _____

Mbasi e vizitoi të sëmurën / sëmurin, KMCAP- i Epror _____, konstatoi se vuan nga sëmundja:_____

Mbështetur në dokumentat, diagnozën, natyrën e punës, si dhe kriteret mjekësore:

VENDOSI:

Të caktojë _____ se _____ ka humbur aftësinë për punë në masë të _____, prej datës ___/___/_____ deri më ___/___/_____.

Koha e fillimit të invaliditetit: _____

Këshilla mjekësore për riaftësim: _____

Aftësia për punë:_____

Rikontroll në KMCAP-in Epror _____, në muajin _____.

Invalidi _____, ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme të një personi tjetër.

Shënim:_____

Relatori (_____)

Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
(_____)	(_____)	(_____)	(_____)

KRYETARI I KOMISIONIT

(_____)

VENDIM
Nr. 506, datë 10.6.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 745, DATË 5.9.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN E QENDRËS SHUMËFUNKSIONALE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL NË KAMZË DHE FUNKSIONIMIN E SAJ GJATË PERIUDHËS KALIMTARE 2013 – 2018"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të shkronjës "b", të nenit 7, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", dhe të ligjit nr. 10247, datë 4.3.2010, "Për kornizën shqiptare të kualifikimeve", me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 745, datë 5.9.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën "c", të pikës 3, emërtimi "...Ministria e Arsimit dhe Shkencës..." zëvendësohet me "...ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë...".

2. Në pikën 4, emërtimi "...ministri i Arsimit dhe Shkencës..." zëvendësohet me "...ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë...".

3. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"6. Statuti i QSHAFP-së, për periudhën kalimtare, miratohet nga ministri përgjegjës për çështjet sociale.".

4. Pika 7 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

"7. Gjatë fazës kalimtare bordi i QSHAFP-së quhet bordi i drejtimit. Detyrat dhe funksionet e tij përcaktohen në statutin e QSHAFP-së, përshtatur gjatë kësaj faze sipas kërkesave të veçanta të saj.

Bordi i drejtimit të QSHAFP-së Kamzë përbëhet nga:

a) një përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale;

b) një përfaqësues i Drejtorisë Arsimore Rajonale përkatëse;

c) dy përfaqësues nga sektori privat, që lidhet me profilet që ofron QSHAFP-ja;

ç) një përfaqësues i Bashkisë Kamzë;

d) një përfaqësues i personelit mësimdhënës të shkollës;

dh) një përfaqësues nga organizatat ose programet ndërkombëtare që mbështetin teknikisht dhe financiarisht QSHAFP-në.

Kjo përbërje e bordit do të jetë deri në përfundim të fazës kalimtare.".

5. Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"8. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të bordit të drejtimit dhe sekretariatit të tij përcaktohen në statutin e QSHAFP-së.".

6. Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"12. QSHAFP-ja Kamzë ka të drejtë të kryejë veprimtari ekonomike me përfitime financiare, në fushat që kanë lidhje me zbatimin e programeve dhe praktikave mësimore, dhe të përdorë, në mënyrë të pavarur, 100 % të të ardhurave që rezultojnë nga këto aktivitete. Tarifat për shërbimet që do të ofrojë QSHAFP-ja Kamzë miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Financave dhe ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Realizimi i veprimtarisë ekonomike bëhet nëpërmjet kontratave të rregullta me personat fizikë dhe juridikë palë, ku të drejtat dhe detyrimet e palëve janë të përcaktuara qartë. Të ardhurat e krijuara nga veprimtaria ekonomike taksohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Edhe dhurimet, financimet e huaja dhe burime të tjera të kësaj natyre administrohen 100 % nga QSHAFP-ja Kamzë, sipas planit të administrimit të kësaj kategorie financimesh, të miratuar nga bordi i drejtimit.".

7. Pika 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"14. Struktura dhe organika e QSHAFP-së miratohen nga ministri përgjegjës për çështjet sociale, brenda numrit të punonjësve të miratuar për Shkollën e Mesme Profesionale Kamzë.".

8. Pika 16 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"16. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të parashikuara për mbulimin e pagave, sigurimeve shoqërore, shpenzimet për blerje materialesh e shërbimesh si dhe fondet për investime, që nga data 1 janar 2015 të përballohen nga buxheti vjetor i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe të ardhurat nga veprimtaria ekonomike.".

9. Pika 17 shfuqizohet.

10. Pika 18 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"18. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi "Gjergj Fishta",
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot",
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 420 lekë